

VENDIM
Nr. 325, datë 22.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 643, DATË 23.12.2020, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE STANDARDE PËR ORGANIGRAMËN, PËRSHKRIMIN E DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË KATEGORIVE TË PUNONJËSVE TË GJYKATËS SË LARTË”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 89, 94, pikat 1 dhe 3 dhe nenin 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 643, datë 23.12.2020, “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në lidhjen 2, përshkrimi standard i detyrave dhe i përgjegjësiive për secilën kategori të punonjësve të Gjykatës së Lartë, për pozicionin këshilltar ligjor, kapitulli XII “Kritere të veçanta”, ndryshohet si më poshtë:

- a) në nënndarjen, “Përvoja”: numri “10” zëvendësohet me numrin “5”;
- b) në nënndarjen “Aftësi të tjera”: fjalia *“të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës”*, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami